



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 03 dhjetor 2020
Nr. ref.:RK 1647/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI139/19

Parashtrues

Riad Bejtullahu

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml.nr. 86/2019, të 2 prillit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gerxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Riad Bejtullahu me vendbanim në Komunën e Gjilanit, të cilin e përfaqëson Elmi Qerimi, avokat nga Gjilani (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Pml.nr.86/2019] e 2 prillit 2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktvendimin [PAM.nr. 77/2018] e 7 dhjetorit 2018 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktvendimin [PM.nr.89/2018] e 22 tetorit 2018 të Departamentit për të Mitur të Gjykatës Themelore në Gjilan (në tekstin në vijim: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar përmes së cilit, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës, i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin në vijim: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

5. Më 2 shtator 2019, parashtruesi i kërkesës përmes postës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 10 shtator 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).
7. Më 1 tetor 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi (i) autorizimin për përfaqësim në Gjykatë; dhe (ii) Aktvendimin [PM. nr. 89/2018] e 22 tetorit 2018 të Gjykatës Themelore. Gjithashtu, në të njëjtën datë, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për kontestimin e Aktgjykimit [Pml.nr. 86/2019] të 2 prillit 2019 dhe të njëjtës i ofroi një kopje të kërkesës.
8. Më 1 tetor 2019, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore dërgimin e fletëkthesës që dëshmon datën e pranimit të Aktgjykimit të kontestuar nga ana e parashtruesit të kërkesës.

9. Më 14 tetor 2019, Gjykata Themelore, nën pretendimin e dërgimit të fletëkthesës së pranimit të Aktgjykimit të kontestuar, dërgoi fletëkthesën e një Aktvendimi tjetër.
10. Më 18 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatë plotësimin e kërkesës, duke dorëzuar gjithashtu dokumentet e kërkuara, autorizimin dhe Aktvendimin [PM.nr.89/2018] e 22 tetorit 2018 të Gjykatës Themelore.
11. Më 23 dhjetor 2019, Gjykata e përsëriti kërkesën për Gjykatën Themelore për rridërgimin e fletëkthesës e cila dëshmon datën e pranimit të Aktgjykimit të kontestuar nga ana e parashtruesit të kërkesës.
12. Më 20 janar 2020, Gjykata Themelore e dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e pranimit të Aktgjykimit të kontestuar nga ana e parashtruesit të kërkesës në të cilën figuronte data 3 maj 2019.
13. Më 10 nëntor 2020, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Bazuar në shkresat e lëndës, ndaj parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore kishte shqiptuar (i) masën disiplinore e qortimi gjyqësor për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor të përcaktuar përmes nenit 188 (Lëndimi i lehtë trupor) të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPRK) përmes Aktvendimit [PM.19/2017]; dhe (ii) masën edukative mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit në kohëzgjatje prej 1 (një) viti për shkak të veprës penale të përcaktuara përmes nenit 187 (Sulmi) të KPRK-së dhe veprës penale vjedhja të përcaktuar përmes paragrafit 1 të nenit 325 (Vjedhja) të KPRK-së përmes Aktvendimin [PM.nr.128/2017] të 15 shkurtit 2018.
15. Më 31 maj 2018, bazuar në shkresat e lëndës, parashtruesi i kërkesës në bashkëveprim me disa persona të tjerë kishte marrë pjesë në një rrahje si rezultat i së cilës, dëmtime të rënda trupore i ishin shkaktuar personit F.A.
16. Më 1 qershor 2018, Stacioni Policor në Gjilan, dorëzoi kallëzimin penal ndaj parashtruesit të kërkesës në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Gjilan (në tekstin e mëtejshëm: Prokuroria Themelore), për shkak të veprës penale vrasje në tentativë të përcaktuar përmes nënparagrafit 1.1 të paragrafit 1 të nenit 178 (Vrasja) lidhur me nenin 28 (Tentativa) të KPRK-së.
17. Më 18 qershor 2018, përgjatë marrjes në pyetje nga Prokurori i Prokurorisë Themelore, parashtruesi i kërkesës kishte mohuar kryerjen e veprës penale dhe kishte identifikuar personin I.J., si atë i cili kishte shkaktuar lëndimet personit F.A. Mbrojtja e parashtruesit të kërkesës gjithashtu kishte propozuar dëgjimin e policit M.S., i cili sipas tyre, ka qenë në vend të ngjarjes më 31 maj 2018.
18. Më 4 korrik 2018, Prokuroria Themelore, parashtrroi propozimin [PPM.nr.113/2018] për shqiptimin e masës edukative të dërgimit në institucionin edukativo-korrektues ndaj parashtruesit të kërkesës, siç është

përcaktuar në nenin 28 (Dërgimi në institucionin edukativo–korrektues) të Kodit nr. 03/L-193 të Drejtësisë për të Mitur (në tekstin në vijim: KDM).

19. Më 11 tetor 2018, në shqyrtimin fillestar para Gjykatës Themelore, në prezencë të mbrojtësit të tij, parashtruesi i kërkesës kishte pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale vrasje e mbetur në tentativë, siç është përcaktuar përmes nenit 178 në lidhje me nenin 28 të KPRK-së. Mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës, kishte deklaruar ndër të tjerash se *“ky pranim është bërë plotësisht në pajtim me dispozitat ligjore”*. Deklaratën e tij e kishin mbështetur parashtruesi i kërkesës dhe babai i tij, në cilësinë e përfaqësuesit të tij ligjor.
20. Më 22 tetor 2018, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PM. nr. 89/2018]: (i) revokoi masën edukative të mbikëqyrjes së shtuar nga ana e prindit të shqiptuar përmes Aktvendimit [PM.nr.128/2017] të 15 shkurtit 2018; ndërsa (ii) parashtruesit të kërkesës i shqiptoi masën edukative të dërgimit në institucionin edukativo-korrektues në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, siç është përcaktuar në nenin 28 të KDM-së.
21. Përmes Aktvendimit të lartpërmendur, Gjykata Themelore mori në konsideratë edhe faktet vijuese (i) ndaj parashtruesit të kërkesës përmes Aktvendimit [PM.19/2017] të të njëjtës gjykatë i ishte shqiptuar masa disiplinore e qortimit gjyqësor për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor të përcaktuar përmes nenit 188 të KPRK-së; (ii) përmes Aktvendimit [PM.nr.128/2017] të 15 shkurtit 2018 i ishte shqiptuar masa edukative mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, për shkak të veprave penale të përcaktuara përmes nenit 187 të KPRK-së dhe paragrafit 1 të nenit 325 të KPRK-së; dhe (iii) anketën sociale [A.nr.Gji-18-0260] të 13 qershorit 2018 të Shërbimit Sprovues të Kosovës. Gjykata kishte arsyetuar revokimin e masës paraprake dhe shqiptimin e masës edukative të dërgimit në institucionin edukativo-korrektues, duke u referuar në nenin 37 (Shqiptimi i masës edukative dhe i burgimit për të mitur për vepra penale në bashkim) të KDM-së, bazuar në të cilin, shqiptimi i masës edukative dhe i burgimit për të mitur zbatohet edhe në rastet kur i mituri ka kryer vepër tjetër penale para ose pas shqiptimit të një mase edukative.
22. Më 29 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë ndaj Aktvendimit [PM. nr. 89/2018] të 22 tetorit 2018 të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, me propozimin e anulimit të Aktvendimit përkatës. Në ankesën përkatëse, parashtruesi i kërkesës në esencë dhe ndër tjerash, kishte theksuar se (i) më 18 qershor 2018, i mituri para Prokurorit të Shtetit kishte mohuar kryerjen e veprës penale, duke e identifikuar personin i cili kishte përdorur *“mjetin e papërshtatshëm për shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore”*, dhe i cili kishte dëmtuar pjesëmarrësin tjetër në rrahje, përkatësisht personin F.A., gjithashtu duke propozuar dëgjimin e policit M.S., në cilësinë e dëshmitarit; dhe se përkundër këtij fakti, (ii) në shqyrtimin gjyqësor fillestar të 11 tetorit 2018, kishte pranuar fajësinë, pa i kuptuar pasojat dhe natyrën e këtij veprimi, nën presion dhe *“i kushtëzuar edhe nga të pandehurit e tjerë të mitur”* për të pranuar fajësinë në mënyrë që çështja penale të *“mbyllet me propozimet të cilat i ka dhënë Prokurori i Shtetit”*; (iii) se në marrjen e vendimit, gjykata nuk ka shqyrtuar provat në tërësinë e tyre, posaçërisht për sa i përket deklaratës së të miturit të dhënë para Prokurorit të Shtetit më 18 qershor 2018 dhe deklaratën e

tij kur e ka pranuar fajësinë më 11 tetor 2018; (iv) se në ndërrimin e masës edukative, përkatësisht ndryshimin e propozimit të Prokurorit të Shtetit për vendosjen e masës së mbikëqyrjes së prindit dhe shqiptimin e masës edukative të dërgimit në institucionin edukativo-korrektues me kohëzgjatje prej një (1) viti, trupi gjykues kishte *“tejkeluar”* kompetencat e tij, për më tepër, që gjithashtu (v) kishte vepruar në kundërshtim me nenin 8 (Zgjedhja e masave dhe e dënimeve të zbatueshme) të KDM-së sepse *“nga shërbimi sprovues nuk e ka kërkuar raportin para ndëshkues”*.

23. Më 8 nëntor 2018, Prokuroria e Apelit përmes parashtresës [PPAM/I.nr.108/2018] propozoi që ankesa e parashtruesit të kërkesës të refuzohet si e pabazuar, si dhe të vërtetohet Aktvendimi i ankimuar.
24. Më 7 dhjetor 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PAM.nr. 77/2018] refuzoi si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës, dhe vërtetoi Aktvendimin [PM. nr. 89/2018] e Gjykatës Themelore.
25. Më 13 mars 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ndaj Aktvendimit [PAM.nr.77/2018] të 7 dhjetorit 2018 të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal. Gjithashtu edhe përmes kësaj kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, parashtruesi i kërkesës përsëriti të njëjtat pretendime të cilat i kishte paraqitur para Gjykatës së Apelit. Në anën tjetër, Prokurori i Shtetit, përmes parashtresës [KMLP.II.nr.64/2019] të 20 marsit 2019, propozoi që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.
26. Më 2 prill 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml.nr.86/2019] refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës, kundër Aktvendimit [PAM.nr. 77/2018] të 13 marsit 2019 të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktvendimin [PM. nr. 89/2018] e 22 tetorit 2018 të Gjykatës Themelore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar [Pml.nr. 86/2019] i 2 prillit 2019 i Gjykatës Supreme i cili ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij themelore të garantuara përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
28. Parashtruesi i kërkesës, në këtë kontekst, pretendon shkelje të parimit të barazisë së armëve, duke pretenduar se në procedurat para gjykatës, në kundërshtim me nenet e lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, është vënë në *“pozitë substancialisht më të pafavorshme”* në raport me Prokurorinë e Shtetit.
29. Parashtruesi i kërkesës specifikisht pretendon se pas dhënies së deklaratës së tij në Prokurori më 18 qershor 2018, ai ka propozuar (i) të identifikohet madhori I.J. i cili sipas tij e ka goditur të dëmtuarin F.A. dhe ndaj parashtruesit të kërkesës të pushohen hetimet për veprën penale vrasje në tentativë; dhe (ii) të dëgjohet polici M.S., në cilësi të dëshmitarit, i cili kishte vërejtur ngjarjen dhe “i

ka parë personat dhe format e goditjeve të ushtruara ndaj të dëmtuarit". Sipas parashtruesit të kërkesës moslejimi i dëgjimit të policit M.S., në cilësinë e dëshmitarit nga ana e Prokurorisë së Shtetit, ka rezultuar me shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin e pikës d) të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së; ndërsa gjithashtu pretendon se (iii) përderisa ai ka pranuar fajësinë *"pa e kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë"*, Kryetari i Trupit Gjykses ka pranuar *"deklaratën sipërfaqësore"*, përkatësisht pranimin e fajësisë së parashtruesit të kërkesës, *"pa i vërtetuar faktet relevante lidhur me këtë çështje penale"*.

30. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të (i) shpallë kërkesën e tij të pranueshme; (ii) konstatojë se Aktgjykimi [PML. nr. 86/2019] i 2 prillit 2019 i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [PML. nr. 86/2019] e 2 prillit 2019 të Gjykatës Supreme në lidhje me Aktvendimin [PAM. nr. 77/2018] e 7 dhjetorit 2018 të Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimin [PM. nr. 89/2018] e 22 tetorit 2018 të Gjykatës Themelore; (iv) kthejë në rigjykim Aktvendimin [PM. nr. 89/2018] e 22 tetorit 2018 të Gjykatës Themelore; dhe në fund, (v) të urdhërojë Gjykatën Themelore që ta njoftojë Gjykatën lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

[...]

7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.
2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.
3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:
 - a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;
 - b. t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;
 - c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;
 - d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;
 - e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

Kodi Nr. 03/L-193 i Drejtësisë Për Të Mitur

Neni 8

Zgjedhja e masave dhe e dënimeve të zbatueshme

1. Kur ndaj të miturit shqiptohet ndonjë masë apo dënim, gjykata në radhë të parë merr parasysh interesin më të mirë të të miturit. Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe këto rrethana: llojin dhe peshën e veprës penale, moshën e të miturit, nivelin e zhvillimit psikologjik, karakterin e tij dhe prirjet, motivet që e nxitën atë të kryejë veprën penale, edukimin e tij në atë fazë, mjedisin dhe rrethanat e jetës së tij, nëse është shqiptuar masë apo dënim më herët dhe rrethanat tjera që mund të ndikojnë në shqiptimin e masës apo dënimit.
2. Shërbimi provues përgatit anketë të plotë sociale për të miturin me kërkesë të prokurorit publik, gjyqtarit për të mitur ose gjykatës ashtu siç është paraparë në këtë Kod. Anketa sociale përfshin të dhëna mbi moshën e të miturit dhe zhvillimin psikologjik, biografinë e familjes, biografinë dhe

rrethanat nën të cilat jeton i mituri, nivelin shkollor, përvojën edukative dhe qfarëdo të dhëne tjetër relevante.

3. Para zgjedhjes së masës apo dënimit, gjykata mund të kërkojë nga shërbimi sprovuës raportin para ndëshkues dhe mendimin lidhur me zgjedhjen e masës apo dënimit.

Neni 28

Dërgimi në institucionin edukativo–korrektues

1. Gjykata e shqipton masën e dërgimit në një institucion edukativo-korrektues kur i mituri i cili ka kryer vepër penale të dënueshme me burgim prej më shumë se tre (3) vjet ka nevojë për edukim të specializuar dhe kur masa e tillë është në interesin më të mirë të të miturit.

2. Kur gjykata vendos për shqiptimin e kësaj mase, ajo merr parasysh peshën dhe natyrën e veprës penale dhe nëse të miturit më parë i është shqiptuar masë edukative ose dënim me burgim për të mitur.

3. Kohëzgjatja e kësaj mase nuk mund të zgjasë më pak se një (1) vit ose më shumë se pesë (5) vjet.

Neni 37

Shqiptimi i masës edukative dhe i burgimit për të mitur për vepra penale në bashkim

1. Për vepra penale në bashkim gjykata shqipton vetëm një masë edukative ose vetëm dënim me burgim për të mitur kur kushtet ligjore për shqiptimin e dënimit të tillë janë përmbushur dhe gjykata konstaton se ai duhet të shqiptohet.

2. Paragrafi 1 i këtij neni po ashtu zbatohet në rastet kur i mituri ka kryer vepër tjetër penale para ose pas shqiptimit të masës edukative ose të burgimit për të mitur.

Neni 73

[Pa titull]

1. Trupi gjykues për të mitur nuk është i lidhur me propozimin e prokurorit me rastin e marrjes së vendimit të tij për llojin e masës ose dënimit që do të shqiptohet.

[...]

Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale

Neni 248

Pranimi i fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar

1. Kur i pandehuri pranon fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës sipas nenit 246 ose 247 të këtij Kodi, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues përcakton nëse:

1.1. i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit;

1.2. pranimi bëhet vullnetarisht nga i pandehuri pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin, nëse i pandehuri ka mbrojtës;

1.3. pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e

aktakuzës të pranuar nga i pandehuri dhe çdo provë tjetër, siç është dëshmia e dëshmitarëve e paraqitur nga prokurori i shtetit ose i pandehuri; dhe

1.4. aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

2. Në vlerësimin e pranimi të fajësisë së të pandehurit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë mendimin e prokurorit të shtetit, mbrojtësit dhe të dëmtuarit.

3. Kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nuk bindet se janë vërtetuar faktet nga paragrafi 1. i këtij neni, ai merr aktvendim me të cilin refuzon pranimin e fajësisë dhe procedon shqyrtimin fillestar sikur pranimi i fajësisë të mos ishte bërë.

4. Kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues bindet se janë vërtetuar faktet nga paragrafi 1. i këtij neni, ai merr aktvendim me të cilin pranon pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe vazhdon me shqiptimin e dënimit, caktimin e seancës për vërtetimin e ndonjë fakti relevant për dënimin ose pezullon dënimin deri në përfundimin e bashkëpunimit të të pandehurit me prokurorin e shtetit.

[...]

Pranueshmëria e kërkesës

31. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

32. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

33. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 (Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individidi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...".

34. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml.nr.86/2019] e 2 prillit 2019 të Gjykatës Supreme dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
35. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) në veçanti përcakton që:

Rregulli 39
(Kriteret e pranueshmërisë)

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

36. Gjykata, fillimisht thekson që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Me saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
37. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si "qartazi e pabazuar" në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave si "pretendime qartazi

të pabazuara". Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime *"të shkallës së katërt"*; (ii) pretendime që kategorizohen me një *"mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes"*; (iii) pretendime *"të pambështetura apo të paarsyetuara"*; dhe në fund, (iv) pretendime *"konfuze dhe të paqarta"*. (Shih, më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si *"qartazi të pabazuar"*, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si *"qartazi të pabazuara"*, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë të 31 gushtit 2019; pjesën III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri më 284).

38. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
39. Në këtë aspekt, fillimisht Gjykata rikujton që rrethanat e rastit ndërlidhen me të akuzuarit dhe më pas të shpallurit fajtor të parashtruesit të kërkesës për veprën penale të vrasjes në tentative, si pasojë e të cilit të njëjtit iu caktua masa edukative e dërgimit në institucionin edukativo-korrektues në kohëzgjatje prej 1 (një) viti nga Gjykata Themelore. Kjo masë u caktua si rezultat i pranimi të fajësisë nga ana e parashtruesit të kërkesës, në praninë e mbrojtësit të tij, në shqyrtimin fillestar të mbajtur në Gjykatën Themelore më 11 tetor 2018. Në ankesën dhe kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pasuese, respektivisht në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme, parashtruesi i kërkesës, kontestoi pranimin e kësaj fajësie, duke theksuar ndër tjerash dhe në esencë, se nuk i kishte kuptuar pasojat e saj, dhe duke pretenduar gjithashtu se Gjykata Themelore nuk kishte marrë parasysh provat dhe posaçërisht faktin që parashtruesi i kërkesës në deklaratën e tij para Prokurorit të çështjes, kishte mohuar kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, kishte identifikuar kryesin e të njëjtës dhe kishte propozuar dëgjimin e dëshmitarit M.S. Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kishte refuzuar ankesën dhe kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë si të pabazuar. Të njëjtat pretendime parashtruesi i kërkesës i ngrit edhe para kësaj Gjykate, duke theksuar ndër tjerash se Aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij themelore për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe posaçërisht të parimit të barazisë së armëve, sepse (i) në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 31 të Kushtetutës dhe pikën d) të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së nuk është dëgjuar dëshmitari i propozuar nga mbrojtja e parashtruesit të kërkesës; dhe se (ii) Gjykata ka pranuar *"deklaratën sipërfaqësore"*, përkatësisht pranimin e fajësisë së parashtruesit të kërkesës, *"pa i vërtetuar faktet relevante lidhur me këtë çështje penale"*.
40. Këto pretendime, Gjykata do t'i shqyrtojë veç e veç në vijim, duke filluar me pretendimin e parë e që ndërlidhet me barazinë e armëve dhe të drejtën e parashtruesit të kërkesës për të kërkuar që të merren në pyetje dëshmitarët në

favor të tij në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës, siç është e përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me pikën d) të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së, shqyrtim ky përgjatë të cilit, Gjykata (i) do të shtjellojë parimet e përgjithshme të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në këtë kontekst, dhe më pas (ii) do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret. Më pas do të vazhdojë me shqyrtimin e pretendimit të dytë, e që në thelb, ndërlidhet me aplikimin e dispozitave procedurale në pranimin e deklarimit të fajësisë nga parashtruesi i kërkesës në shqyrtimin fillestar nga trupi përkatës gjykues në Gjykatën Themelore.

(i) Parimet e përgjithshme përkitazi me barazinë e armëve

41. Për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, Gjykata thekson se parimi i barazisë së armëve është një tipar i qenësishëm i një gjykimi të drejtë. Në parim, ai kërkon që secilës palë në procedurë t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur rastin e tij në kushte të cilat nuk e vendosin atë në disavantazh kundrejt kundërshtarit të tij. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Öcalan kundër Turqisë*, Aktgjykim i 12 majit 2005, paragrafi 140; *Foucher kundër Francës*, Aktgjykim i 18 marsit 1997, paragrafi 34; *Bulut kundër Austrisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 1996; dhe *Faig Mammadov kundër Azerbajxhanit*, Aktgjykimi i 26 janarit 2017, paragrafi 19). Ky parim është gjithashtu i lidhur ngushtë me të drejtën për një seancë në të cilën mund të kundërshtohen provat e që do të thotë, në parim, mundësinë e palëve që të kenë njohuri dhe të komentojnë mbi të gjitha provat e paraqitura e që mund të ndikojnë në vendimin e gjykatës. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Brandstetter kundër Austrisë*, Aktgjykim i 28 gushtit 1991, paragrafi 67).
42. GJEDNJ-ja ka shqyrtuar çështje që ndërlidhen me barazinë e armëve dhe gjykimin në të cilin mund të kundërshtohen provat në një numër të madh rastesh, shumë shpesh duke i ndërthurur në këtë shqyrtim edhe të drejtat e mbrojtjes të garantuara përmes paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së. Për shembull, GJEDNJ ka konstatuar shkelje të paragrafit 1 në lidhje me paragrafin 3 të nenit 6 të KEDNJ-së në procedurat penale, ndër të tjera, atëherë kur të drejtat e mbrojtjes ishin të kufizuara për shkak të mungesës paraprake të qasjes në parashtruesat e prokurorisë (shih, rastin e GJEDNJ-së *Zahirović kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 25 prillit 2015, paragrafët 44-50) ose kur një parashtruesi nuk iu lejua të ishte i pranishëm në një seancë dëgjimore para gjykatës përkatëse përderisa përfaqësuesi i prokurorisë ishte i pranishëm (shih, rastin e GJEDNJ-së *Eftimov kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, Aktgjykim i 2 korrikut 2015, paragrafi 41).
43. Për sa i përket refuzimit të gjykatave për të dëgjuar dëshmitarët, e që është një nga pretendimet e parashtruesit të kërkesës në rrethanat e rastit konkret, GJEDNJ ka theksuar, në parim, se (i) refuzimi i një gjykate për të dëgjuar ndonjë dëshmitar ose për të shqyrtuar ndonjë provë të mbrojtjes, përderisa pranohet paraqitja e dëshmitarëve dhe provave të prokurorisë, mund të ngrejë çështje nga këndvështrimi i barazisë së armëve (shih, rastet e GJEDNJ-së *Borisova kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 21 dhjetorit 2006, paragrafët 47-48; dhe *Topić kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 10 tetorit 2013, paragrafi 48); duke pohuar gjithashtu se të njëjtat shqetësime do të jenë të vlefshme edhe nëse (ii) gjykata refuzon të dëgjojë dëshmitarë të mbrojtjes për të sqaruar një situatë të pasigurt e cila

përbën bazën ose esencën e akuzave kundër parashtruesit përkatës (shih, rastin e GJEDNJ-së *Kasparov dhe të tjerët kundër Rusisë*, Aktgjykim i 3 tetorit 2013, paragrafët 64-65). Për sa i përket kësaj të fundit, dhe për të përcaktuar nëse procedurat në tërësi ishin të drejta, GJEDNJ zbaton testin e zhvilluar përmes Aktgjykimit *Murtazaliyeva kundër Rusisë*, të njohur sikur testi *Murtazaliyeva*, dhe i cili përbëhet nga tre komponentë: (i) nëse kërkesa për të marrë në pyetje një dëshmitar ishte mjaftueshëm e arsyetuar nga parashtruesi përkatës dhe e rëndësishme për çështjen e akuzës; (ii) nëse gjykata përkatëse e ka vlerësuar rëndësinë e kësaj dëshmie dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme në vendimin e saj për të mos e pranuar një dëshmitar në gjykim; dhe (iii) nëse vendimi i gjykatës përkatëse për të mos marrë në pyetje këtë dëshmitar minon drejtësinë e përgjithshme të procedurës. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Murtazaliyeva kundër Rusisë*, Aktgjykim i 18 dhjetorit 2018, paragrafët 158-177).

44. Nga ana tjetër, paragrafi 4 i nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me pikën d) të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së, garantojnë të drejtën për të marrë në pyetje dëshmitarët dhe për të siguruar pjesëmarrjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në emër të tij në të njëjtat kushte si dëshmitarët kundër tij. Në parim, bazuar në këto nene, para se një i akuzuar të dënohet, të gjitha provat kundër tij duhet të paraqiten në praninë e tij në një seancë publike me qëllim të realizimit të argumentimit kundërshtues në një seancë.

(ii) Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

45. Bazuar në parimet e lartcekura që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, Gjykata rithekson se parimi i barazisë së armëve dhe i të drejtës për një seancë kundërshtuese, është në parim i garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe gjithashtu, në parim, nënkupton që palët para gjykatës duhet të kenë mundësi të barabarta për të paraqitur dëshmitë përkatëse, duke u siguruar që as parashtruesi përkatës të mos vendoset në disavantazh në raport me prokurorinë dhe anasjelltas. Kjo, bazuar në këtë praktikë gjyqësore, në parim vlen, përkitazi me qasjen në të gjitha shkresat dhe provat dhe me mundësinë për të paraqitur dëshmitarë dhe për të kundërshtuar provat e paraqitura para një gjykate.
46. Thënë këtë, dhe përkundër pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, në rrethanat e rastit konkret, para Gjykatës Themelore, nuk është administruar asnjë provë, sepse procedura penale kundër parashtruesit të kërkesës ka përfunduar në shqyrtimin fillestar përmes pranimi të fajësisë.
47. Më saktësisht, në rrethanat e rastit konkret është i aplikueshëm KMD. Ky Kod, për dallim nga Kodi i ri i Drejtësisë për të Mitur, përkatësisht Kodi nr. 06/L-006, nuk rregullon mënyrën e pranimi të fajësisë. Prandaj, bazuar në nenin 5 [pa titull] të tij, zbatohen dispozitat e Kodit Nr.04/L-123 të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPRK), përkitazi me pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar.
48. Bazuar në nenin 245 (Shqyrtimi fillestar) të KPPRK-së, në shqyrtimin fillestar marrin pjesë vetëm Prokurori i Shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij dhe asnjë dëshmitar apo ekspert nuk merret në pyetje dhe asnjë provë nuk paraqitet gjatë këtij shqyrtimi. Nga ky rregull, Kodi i lartcekur parasheh vetëm një përjashtim,

në rastet kur dëshmitari është i nevojshëm për marrjen e vendimit mbi vazhdimin ose zbatimin e masave për të siguruar praninë e të pandehurit, siç është përcaktuar në paragrafin 3 të të njëjtit nen, dhe që nuk është rasti në rrethanat e rastit konkret. Në këtë fazë të procedurës penale, një i pandehur dhe/ose mbrojtësi i tij, mund të deklarohet rreth fajësisë, duke përfshirë pranimin e saj, nën kushtet dhe garancitë e përcaktuara përmes nenit 246 (Pranimi i fajësisë) të KPPRK-së. Për më tepër, neni 248 (Pranimi i fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar) i KPPRK-së, specifikisht rregullon pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, duke saktësuar se në raste të tilla, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, duhet të vlerësojë, ndër të tjerash, nëse (i) i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit; (ii) pranimi bëhet vullnetarisht nga i pandehuri pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin; (iii) pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza; dhe (iv) aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike. Gjithashtu, përgjatë këtij vlerësimi, (i) gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë mendimin e prokurorit të shtetit, mbrojtësit dhe të dëmtuarit; dhe varësisht nga bindja e tij/tyre, (ii) merr aktvendim me të cilin refuzon ose pranon pranimin e fajësisë, siç është përcaktuar në paragrafët 3 dhe 4 të nenit 248 të KPPRK-së. Në rastet kur procedura penale përfundon me pranimin e fajësisë, bazuar në nenin 383 (Arsyet për ushtrimin e ankesës ndaj aktgjykimit) të KPPRK-së, nuk mund të ushtrohet ankesë për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike.

49. Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, në shqyrtimin fillestar të mbajtur para Gjykatës Themelore më 11 tetor 2018, para kësaj gjykate përpos Prokurorit të Shtetit, ishin deklaruar edhe (i) parashtruesi i kërkesës dhe i cili kishte pranuar fajësinë; (ii) mbrojtësi i tij, dhe i cili kishte theksuar se *“pajtohem me deklarimin e të pandehurit të mitur Riad, lidhur me pranimin e fajësisë dhe konsideroj që ky pranim është bërë plotësisht në pajtim me dispozitat ligjore”*; dhe (iii) babai i parashtruesit të kërkesës, në mbështetje të këtyre deklaratave. Gjykata Themelore në pajtim me dispozitat e KPPRK-së lidhur me pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar dhe kërkesat e nenit 8 dhe 37 të KDM-së, kishte vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe kishte shqiptuar masën edukative të dërgimit në institucionin edukativo–korrektues, siç është përcaktuar në nenin 28 të KMD-së.
50. Rrjedhimisht, në shqyrtimin gjyqësor ndaj parashtruesit të kërkesës nuk janë shqyrtuar provat, as të parashtruesit të kërkesës dhe as të Prokurorisë së Shtetit, sepse çështja është përmbyllur në shqyrtimin fillestar me pranimin e fajësisë nga parashtruesi i kërkesës dhe mbrojtësi i tij.
51. Gjykata rikujton që përkritazi me mos shqyrtimin e provave në Gjykatën Themelore, është deklaruar edhe Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml.nr.86/2019] të 2 prillit 2019, duke theksuar si në vijim:

“Në aktvendime janë dhënë arsye të mirëfillta dhe ligjore lidhur me faktet vendimtare mbi bazën e të cilave është marrë vendim meritor, të cilat arsyetime i aprovon edhe kjo gjykatë. Në fakt, kjo gjykatë konstaton se në aktvendim të shkallës së parë fare nuk janë vlerësuar provat sepse i mituri në shqyrtim ka pranuar fajësinë lidhur me veprën e cila i është vënë në barrë, andaj gjykata ka proceduar me shqyrtim gjyqësor pa administrim të

provave. Meqenëse nuk janë administruar provat, në aktvendim edhe nuk ka arsyetim lidhur me provat e administruara dhe si rrjedhojë edhe nuk është bërë vlerësim i provave, në çmënyrë është vepruar në harmoni me dispozitat e ligjit procedural”.

52. Në rrethana të tilla, pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të parimit të barazisë së armëve nuk qëndrojnë sepse në shqyrtimin fillestar nuk është shqyrtuar asnjë provë, prandaj parashtruesi i kërkesës nuk mund të jetë vënë në disavantazh me Prokurorinë e Shtetit, në cenim të parimit të barazisë së armëve. Në shqyrtimin fillestar para Gjykatës Themelore, Prokurori i Shtetit, ka propozuar *“shqiptimin e masës edukative të dërgimit në institucionin edukativo-korrektues”*, ndërsa parashtruesi i kërkesës ka pranuar fajësinë.
53. Për të njëjtën arsye nuk qëndrojnë as pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljen e paragrafit 4 të nenit 31 të Kushtetutës dhe pikës d) të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së me pretendimin se nuk është dëgjuar dëshmitari i propozuar nga mbrojtja e parashtruesit të kërkesës. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se (i) parashtruesi i kërkesës kishte propozuar dëgjimin e dëshmitarit M.S., në fazën e hetimeve para Prokurorisë së Shtetit; ndërsa përkundër këtij fakti (ii) në shqyrtimin fillestar ka pranuar fajësinë; për më tepër që (iii) bazuar në dispozitat e KPPRK-së, kundërshtimi i provave fillon pas shqyrtimit fillestar dhe para shqyrtimit të dytë, siç është përcaktuar në nenin 249 (Kundërshtimi i provave), atëherë kur i pandehuri nuk pranon fajësinë në shqyrtimin fillestar ose kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nuk bindet me pranimin e fajësisë së të pandehurit, dhe nxjerrë aktvendimin me të cilin refuzon pranimin e fajësisë dhe procedon shqyrtimin fillestar sikur pranimi i fajësisë të mos ishte bërë, siç është përcaktuar në nenin 248 të KPPRK-së.
54. Në rrethana në të cilat, Gjykata Themelore nuk ka administruar provat as të Prokurorisë së Shtetit dhe as të parashtruesit të kërkesës, sepse çështja është përmbyllur në shqyrtimin fillestar në bazë të pranimin të fajësisë së të pandehurit, Gjykata thekson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës se vendimet e gjykatave të rregullta janë nxjerrë në shkelje të parimit të barazisë së armëve, siç është garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk qëndrojnë sepse në rrethanat e rastit konkret, para Gjykatës Themelore, nuk është administruar asnjë provë, nuk ka pasur një kërkesë për dëgjimin e dëshmitarit përkatës, dhe rrjedhimisht e njëjta as nuk ka refuzuar dëgjimin e tij. Për pasojë, testi i GJEDNJ-së përkitazi me dëgjimin e dëshmitarëve në një proces gjyqësor, përkatësisht ai i ndërtuar në Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Murtazaliyeva*, nuk është i aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret.
55. Prandaj, bazuar në sqarimet e mësipërme, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës se Aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij themelore për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, dhe posaçërisht të parimit të barazisë së armëve, sepse në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 31 të Kushtetutës dhe pikën d) të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së, nuk është dëgjuar dëshmitari i propozuar nga mbrojtja e parashtruesit të kërkesës, janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese në *“mungesë të dukshme ose të qartë të shkeljes”*.

56. Pas këtij konstatimi, dhe siç është sqaruar më lart, Gjykata në vijim gjithashtu do të shqyrtojë pretendimin e dytë të parashtruesit të kërkesës, sipas të cilit, trupi gjykues ka pranuar pranimin e fajësisë së parashtruesit të kërkesës, "*pa i vërtetuar faktet relevante lidhur me këtë çështje penale*". Gjykata thekson se ky pretendim në esencë ndërlidhet me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe zbatimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm përkitazi me pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar nga trupi gjykues në Gjykatën Themelore, pretendime të cilat, Gjykata në përputhje me praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së, i konsideron si "*pretendime të shkallës së katërt*".
57. Në kontekst të kësaj kategorie pretendimesh, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe duke marrë parasysh veçoritë e saj, siç janë përcaktuar përmes KEDNJ-së. (Shih në këtë kontekst, sqarimin në Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 2. "Shkalla e katërt", paragrafët 262 dhe 263), parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, ajo vazhdimisht e ka theksuar dallimin në mes të "*kushtetutshmërisë*" dhe "*ligjshmërisë*" dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve ose interpretimit dhe aplikimit të gabuar të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose me KEDNJ. (Shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI179/18, parashtrues *Belgjyza Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; KI49/19, parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A.*, "*Adem Jashari*", Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; KI56/17, me parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe KI154/17 dhe KI05/18, me parashtrues, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60).
58. Gjykata gjithashtu ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "*shkallës së katërt*", që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdoruar aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës, KI49/19, cituar më lart, paragrafi 48; dhe KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 61).
59. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me Kushtetutën dhe KEDNJ-në. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39; dhe shih, gjithashtu rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KI05/18,

cituar më lart, paragrafi 63). Në parim, një përjashtim i tillë, ndërlidhet me raste të cilat rezultojnë të jenë dukshëm arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*” në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin përkatës. (Për një sqarim më të detajuar përkitazi me konceptin e “*aplikimit të ligjit në mënyrë qartazi të gabuar*”, shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).

60. Gjykata vlerëson se në rrethanat e rastit konkret, është e rëndësishme të theksohet se paragrafi 7 i nenit 31 të Kushtetutës, përcakton se procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit. Këto të fundit, siç është sqaruar më lart, në rrethanat e këtij rasti janë të përcaktuara përmes, KDM-së dhe bazuar në nenin 5 të tij, edhe ato të KPPRK-së, në mungesë të rregullimit specifik në KMD.
61. Në këtë rast, shqyrtimi fillestar dhe pranimi i fajësisë është bazuar në nenet 245, 246 dhe 248 të KPPRK-së, ndërsa në përcaktimin e masës, janë aplikuar nenet 8, 28, 37 dhe 73 të KMD-së. Bazuar në shkresat e lëndës, rezulton se (i) Gjykata Themelore kishte pranuar fajësinë nga i pandehuri pasi ishin plotësuar kushtet e përcaktuar në nenin 246 të KPPRK-së, ndërsa (ii) masën përkatëse për parashtruesin e kërkesës e kishte shqiptuar bazuar në nenet 8, 28 dhe 37 të KMD-së.
62. Për më tepër, Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme, përmes Aktvendimit [PAM.nr. 77/2018] dhe Aktgjykimit [Pml.nr.86/2019], respektivisht, kishin shqyrtuar të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës të ngritura përmes ankesës dhe kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, me theks në (i) pranimin e fajësisë; (ii) masën e shqiptuar; (iii) pretendimin se Gjykata kishte “*tejkalluar*” kompetencën e saj përmes ndërrimit të masës edukative, përkatësisht ndryshimin e pretenduar të propozimit të Prokurorit të Shtetit për vendosjen e masës së mbikëqyrjes së prindit dhe shqiptimin e masës edukative të dërgimit në institucionin edukativo-korrektues me kohëzgjatje prej një (1) viti; dhe (iv) pretendimin se në kundërshtim me nenin 8 të KDM-së, Gjykata Themelore “*nga shërbimi sprovues nuk e ka kërkuar raportin para ndëshkues*”.
63. Gjykata thekson se përkitazi me çështjen e parë, përkatësisht pranimin e fajësisë së parashtruesit të kërkesës nga Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit, ndër të tjera, kishte arsyetuar si në vijim:

“Nga Aktvendimi i ankimuar, por edhe nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, shihet se i mituri Riad Bejtullahu, e kishte pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale vrasje e mbetur në tentativë, nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK dhe ky pranim i fajësisë nga ana e të miturit ishte bërë në prezencë të mbrojtësit të tij, avokatit Elmi Qerimi. Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton se është zbatuar në mënyrë të drejtë neni 248 i KPP që ka të bëjë me pranimin e fajësisë, për shkak se gjykata e shkallës së parë pasi që i mituri e kishte pranuar fajësinë, kishte marrë aktvendim me të cilin e kishte bërë pranimin e fajësisë, duke konsideruar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë, ku me këtë rast është konstatuar se i mituri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit; se pranimi i

fajësisë është bërë vullnetarisht nga i mituri pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban propozimi i Prokurorisë Themelore në Gjilan. Në anën tjetër shihet se i mituri Riad Bejtullahu, e kishte pranuar fajësinë edhe gjatë deklarimeve të tij të mëparshme, kurse në anën tjetër, i njëjti është konstatuar se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, ku një gjë të tillë e kishte bërë pas konsultimeve edhe me mbrojtësin e tij, andaj si rezultat i të gjitha këtyre që u cekën më lartë, Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton se nuk është bërë kurrfarë shkelje e dispozitës së lartcekur ligjore që i referohet pranimi të fajësisë nga ana e të miturit. “

64. Ndërsa, Gjykata Supreme, në këtë kontekst, gjithashtu kishte theksuar si në vijim:

“Qëndron fakti se i mituri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ka ngarkuar propozimi i prokurorisë dhe i njëjti që nga momenti i parë i procedurës penale të iniciuar kundër tij, ka pasur mbrojtës (mbrojtësi i cili edhe e ka përpiluar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) ndërsa në shqyrtim gjyqësor gjykata ka konstatuar se i mituri pasi që i është lexuar propozimi nga ana e prokurorit, ka deklaruar se e kupton pranimin e fajësisë dhe se këtë pranim e bën në mënyrë vullnetare dhe se i kupton benefitet dhe pasojat e pranimi të fajësisë. Ndërsa Gjykata më tutje në procesverbal ka konstatuar se trupi gjykues ka vlerësuar se i mituri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë dhe se ky pranim është bërë vullnetarisht dhe pas konsultimit me mbrojtësin e tij dhe se mbështetet në faktet e çështjes që i përmban paragrafi 1 i KPPK-së. Pra, i mituri jo vetëm gjatë procedurës penale, por edhe në shqyrtim gjyqësor ka pasur mbrojtje të garantuar ashtu siç e parasheh ligji, i njëjti është konsultuar me mbrojtësin e tij i cili ka qenë prezent dhe i cili ka pasur mundësi që ta këshillojë lidhur me pasojat e pranimi të fajësisë, aq më tepër në qoftë se i mituri eventualisht ka qenë i shtrënguar apo në të njëjtin është bërë presion të pranojë fajësinë. Me të drejtë trupi gjykues ka konstatuar se i mituri ka kuptuar pasojat dhe benefitet e pranimi të fajësisë e i cili pranim është bërë konform dispozitës së nenit 248 paragrafi 1 të KPPK-së, që e bën të pabazuar edhe këtë pretendim.”

65. Më tej, Gjykata thekson se përkitazi me çështjen e dytë, përkatësisht masën e shqiptuar nga Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit, ndër të tjera, kishte arsyetuar si në vijim: *“Në arsyetimin e aktvendimit të ankimuar janë paraqitur arsyet e duhura dhe të mjaftueshme lidhur me faktet relevante juridike, pas së cilës gjykata e shkallës së parë kishte vendosur që ndaj Riad Bejtullahut, ta shqiptoj masën edukative dërgimi në institucionin edukativo korrektues”.*

66. Ndërsa, Gjykata Supreme, në këtë kontekst, gjithashtu kishte theksuar si në vijim: *“Kjo gjykatë [...] konstatoi se i mituri Riad Bejtullahu është gjykuar për shkak të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPPK-së dhe për këtë vepër penale i është shqiptuar masa edukative dërgimi në Institucionin Edukativo Korrektues në kohëzgjatje prej 1 (një) viti. Qëndron fakti se ndaj të miturit është revokuar masa edukative mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit sepse konform nenit 37 të KDM, është përcaktuar se për vepra penale në bashkim, gjykata shqipton vetëm një masë edukative ose vetëm një*

dënim, kurse në par. 2 të këtij neni thuhet se par.1 zbatohet në rastet kur i mituri ka kryer vepër tjetër penale para ose pas shqiptimit të masës edukative ose burgimit për të mitur. Nga shkresat vërtetohet se i mituri kishte të shqiptuar një masë edukative – mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit në kohëzgjatje prej 1 viti për shkak të veprave penale – sulm nga neni 187 të KPK dhe vjedhje nga neni 325 par. 1 të KPK, andaj drejt ka vepruar gjykata e shkallës së parë kur ka revokuar këtë masë edukative dhe të njëjtit i ka shqiptuar masën edukative, dërgimi në Institucionin Edukativo-Korrektues, e çka e bën të pabazë pretendimin e mbrojtësit”.

67. Përkitazi me çështjen e tretë, përkatësisht pretendimin e parashtruesit të kërkesës se Gjkata Themelore kishte *“tejkeluar”* kompetencën e saj përmes ndërrimit të masës edukative, përkatësisht ndryshimin e propozimit të Prokurorit të Shtetit për vendosjen e masës së mbikëqyrjes së prindit dhe shqiptimin e masës edukative të dërgimit në institucionin edukativo-korrektues me kohëzgjatje prej një (1) viti, Gjkata vëren se (i) bazuar në Aktvendimin [PM. nr. 89/2018] e Gjykatës Themelore, Prokuroria Themelore, përmes shkresës [PPM.nr. 113/2018] të 4 korrikut 2018, në fakt kishte propozuar shqiptimin e masës edukative dërgimi në institucionin edukativo-korrektues, masë kjo të cilën Gjkata Themelore nuk e ka ndryshuar por e ka shqiptuar; ndërsa (ii) edhe përkundër pretendimit të parashtruesit të kërkesës së Gjykata Themelore ka ndërruar masën edukative të propozuar nga Prokurori i Shtetit, neni 73 i KMD-së, përcakton se trupi gjykues për të mitur nuk është i lidhur me propozimin e prokurorit me rastin e marrjes së vendimit të tij për llojin e masës ose dënimit që do të shqiptohet. Në këtë kuptim këtë pretendim e kanë arsyetuar edhe Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme, respektivisht. E para, ndër të tjera, kishte theksuar se paragrafi 1 i nenit 73 të KDM-së përcakton se *“trupi gjykues për të mitur nuk është i lidhur me propozimin e prokurorit të shtetit lidhur me caktimin e masave apo dënimeve ndaj të miturve, kështu që edhe në këtë drejtim pretendimi i mbrojtësit të të miturit nuk është i bazuar”*; ndërsa e dyta, përkatësisht Gjykata Supreme, kishte theksuar se *“[...] trupi gjykues, sipas kësaj dispozite mund të shqiptojë edhe ndonjë masë që nuk është propozuar nga Prokurori i shtetit dhe me këtë rast nuk bën tejkalimin e propozimit ashtu siç pretendohet në kërkesë”*.
68. Në fund, dhe përkitazi me çështjen e katërt, përkatësisht pretendimin se në kundërshtim me nenin 8 të KDM-së, Gjykata Themelore *“nga shërbimi sprovues nuk e ka kërkuar raportin para ndëshkues”*, Gjykata thekson se paragrafi 3 i nenit 8 të KMD-së, përcakton se para zgjedhjes së masës apo dënimit, gjykata përkatëse mund të kërkojë nga shërbimi sprovues raportin para ndëshkues dhe mendimin lidhur me zgjedhjen e masës apo dënimit, duke i përcaktuar gjykatës përkatëse mundësinë dhe jo detyrimin për të kërkuar nga shërbimi sprovues raportin para ndëshkues dhe mendimin lidhur me zgjedhjen e masës apo dënimit. Kjo për dallim nga Kodi i ri i Drejtësisë për të Mitur, përkatësisht Kodi 06/L-006, dhe i cili në paragrafin 3 të nenit 13 (Zgjedhja e masave dhe e dënimeve të zbatueshme) të tij, përcakton detyrimin e gjykatës përkatëse që para zgjedhjes së masës apo dënimit, të kërkon nga Shërbimi Sprovues raportin para ndëshkues dhe mendimin lidhur me zgjedhjen e masës apo dënimit. Ky i fundit, megjithatë nuk është i aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret. Gjykatat e rregullta e kishin adresuar këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës duke u bazuar në dispozitat e Kodit të aplikueshëm për të mitur,

përkatësisht KMD-së dhe bazuar në të cilin, kërkimi i raportit përkatës dhe mendimit të Shërbimit Sprovues është vetëm mundësi dhe jo detyrim i gjykatës përkatëse. Në këtë aspekt, Gjykata e Apelit kishte theksuar se *“Sa i përket raportit para ndëshkues, kjo është vetëm një mundësi fakultative për gjykatën, për shkak se gjykata mund të shqiptoj masën edukative apo dënimin, edhe pa raport ndëshkues, varësisht nga rrethanat e rastit konkret. Fakti që raporti ndëshkues është mundësi fakultative për gjykatë është parashikuar në nenin 8 paragrafi 3 të KDM, ku është përcaktuar se “para zgjedhjes së masës apo dënimit, gjykata mund të kërkojë nga shërbimi sprovues raportin para ndëshkues dhe mendimin lidhur me zgjedhjen e masës apo dënimit”.*

69. Ndërsa, Gjykata Supreme, çështjen e lartpërmendur e kishte arsyetuar si në vijim: *“Ndërsa, qëndron fakti se në shqyrtimin gjyqësor nuk është ftuar zyrtari sprovues, por sipas dispozitës së nenit 8 par. 3 të KDM, përcaktohet se para zgjedhjes së masës apo dënimit, gjykata mund të kërkojë nga shërbimi sprovues raportin parandëshkues dhe mendimin lidhur me zgjedhjen e masës apo dënimit. Pra, Gjykata nuk është e obliguar që të kërkojë raportin para ndëshkues por i mbetet në diskrecion të saj që të vendosë lidhur me këtë”.*
70. Prandaj, duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtuesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, dhe gjithashtu arsyetimet e gjykatave të rregullta të shtjelluara më lart, Gjykata konsideron se parashtuesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij se gjykatat e rregullta mund të kenë *“aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar”* duke rezultuar në *“konkluzione arbitrare”* apo *“qartazi të paarsyeshme”* për parashtuesin e kërkesës, dhe rrjedhimisht pretendimet e tij për vërtetimin e gabuar të fakteve dhe interpretimin dhe aplikimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm përkitazi me pranimin e fajësisë të parashtuesit të kërkesës nga ana trupit gjykues, kualifikohen si pretendime që bien në kategorinë e *“shkallës së katërt”* dhe si të tilla, reflektojnë pretendime në nivel të *“ligjshmërisë”* dhe nuk janë argumentuar në nivel të *“kushtetutshmërisë”*. Për pasojë, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
71. Rrjedhimisht, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh karakteristikat e veçanta të rastit, pretendimet e ngritura nga parashtuesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se pretendimet e parashtuesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si pasojë e (i) cenimit të barazisë së armëve për shkak të mos dëgjimit të dëshmitarit përkatës, janë qartazi të pabazuara në *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”*; ndërsa (ii) vërtetimit të gabuar të fakteve dhe aplikimit të gabuar të ligjit, janë gjithashtu qartazi të pabazuara në baza kushtetuese si pretendime të *“shkallës së katërt”*.
72. Përfundimisht, Gjykata konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) e 59 (2) të Rregullores së punës, më 10 nëntor 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

Gresa Caka-Nimani



Arta Rama-Hajrizi